



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË

Dt . 20.03.2023 Nr. 131/23

Në mbështetje të nenit 8, paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenit 5, pika c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 ,Ligji nr . 06/L-114 për Zyrtaret Publik ,nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria për Arsime shpallë:

K O N K U R S

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i Lirë	Numri i Pozitave
1	IP	Nëpunës administrativo - teknik dhe mbështetës	Vend i lire	2
2	IP	Kuzhinier /e	Vend i lire	2
3	IP	Shtëpiak	Vend i lire	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë, në Arkiv ose ne web. te Komunës),
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë),
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te Noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasysh,
- Certifikata që nuk jeni nën hetime,
- Dëshmi të përvojës (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar, Ligjit Nr.02/L-52, Ligjit Nr.03/L-068 dhe Ligjit Nr.04/L-138, Ligjit për zyrtaret publik nr . 06/L – 114.

Kriteret e kualifikimit për Punëtor Teknik -Përgatitje e mesme shkollore

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Duhet të respektojë orarin e punës në përpikmëri,
- Kryen pastrimin e korridoreve, klasave, nyjeve sanitare, kabineteve, zyrave dhe lokaleve tjera të IP, po ashtu kujdeset për ndezjen e kalldasë së IP,
- Bën bledhjen e mbeturinave nga pastrimi i lokaleve të IP në vende të caktuara për këtë
- Kujdeset për zbatimin e masave sanitare dhe higjienike në lokalet e IP,
- Është përgjegjës për inventar dhe mjete të tjera që i përdor dhe gjenden në lokale ku embajnë pastërtinë, Kontrollon hyrjet dhe daljet në objekte të IP, mban evidencat lidhur me këtë,

- Gjatë orarit të punës së tij i kontrollon të gjitha lokalet e IP dhe i evidenton të gjitha parregullësitë në librin e kujdestarisë,
- Gjatë orarit të punës së tij e kontrollon objektin dhe rrethin e IP dhe kujdeset që të mos ndodh zjarr, vërshime ose plaçkitje,
- Në rast të fatkeqësive të ndryshme, është i obliguar që t'u jap ndihmë femijeve, Kontrollon hyrjen dhe daljen e automjeteve, punëtorëve dhe femijeve.

Kriteret e kualifikimit për Kuzhinierë :

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm ;
- Të kenë së paku 1 vjet përvojë pune përkatëse ;

Përgjegjësitë dhe detyrat:

- Përgaditja e ushqimit për femijet e kopshtit;
- Mirëmbajtja e nivelit të lartë të pastërtisë së kuzhinës;
- I/e orientuar drejt detajeve dhe në gjendje të mbaj nivel të lartë të përgjegjësisë;
- Pastrimi i mjeteve të punës pas përdorimit të tyre;
- Të jetë bashkpunuese me bashkpuntorët.

Për intervistë do të ftohen ata kandidatë që i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura. Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë si dhe orari i intervistës do të publikohen në web faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

<https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>

Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023/2024. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEM, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listës së publikuar me rastin e shpalljes së rezultateve. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më **21.03.2023 deri me 04.04.2023**.

Aplikacioni i kompletuar me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohet në Komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Arkivit në objektin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

Adresa: Objekti i Komunës, rruga Tahir Zemaj nr.2, Fushë- Kosovë.

